



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.201/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, Kryesues, Skender Çoçaj, dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në hapësirat publike, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 29.01.2025, mori këtë :

V E N D I M

- I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.201/2025, dhe Anr.203/2025 datë 26.01.2025.
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,500.00 €uro (pesëmijëepesqind€uro) €uro.
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 26.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.201/2025 dhe Anr.203, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 26.01.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, në rrugën “Xheladin Hana”, në Prishtinë kanë identifikuar banerët/posterët e vendosura në hapësirat/rrugët publike dhe në stacion të trafikut publik, të kandidatëve për deputetë nga radhët e LDK-së, Lumir Abdixhiku, dhe Alban Zogaj, si dhe në rrugën “ Shpëtim Robaj” kanë identifikuar banerët/posterët e vendosura në hapësirat/rrugët publike dhe në stacion të trafikut publik, të kandidatëve për deputetë nga radhët e LDK-së, Jehona Lushtaku-Sadriu, Ismet Beqiri, Fadil Aliu dhe Nuredin Ibishi- Leka.

Sipas parashtruesit të ankesave me këtë veprim kandidatët dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku parashihet se “Vendosja e njoftimeve,

pillakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Si provë ka bashkangjitur, fotografi që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Kërkojmë nga PZAP-i, që në rast se gjejnë shkelje në këto veprime, të shqiptoj sanksionin e merituar sipas legjislacionit në fuqi.

Më datë 27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për ankesën e parashtruar kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 28.01.2025.

Në përgjigjet në ankesë të paraqitur me datë 28.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pretendon se subjekti politik LDK dhe disa prej kandidatëve për deputet nga Prishtina me rastin e vendosjes së materialeve reklamuese — posterëve në Prishtinë kanë shkelur nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenin 7 paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar konsiderojnë se ligjërisht nuk qëndron. Ne rastin e ankesës A.nr. 201/2025 dhe A.nr. 203/2025 kemi të bëjmë me vendosje të materialit-posterit në pritore të autobusëve dhe në hapësirat/rrugët publike dhe në stacion të trafikut publik. Prova konkrete për rastin në fjalë janë kontrata e lidhur me operatorit ekonomik "Selmans Network "me Komunën e Prishtinës-Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrotjtje dhe Shpëtim, kontratën e lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike me subjektin politik LDK me operatorin ekonomik "Selmans Network" sh.p. k, si dhe sqarimin e shefit të sektorit për menaxhim të hapësirave publike z. Habib Qorri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 118 par. 1 të LZP-së, konstatoi se:

- Ankesat janë të bazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik LDK, referuar disa prej kandidatëve për deputet nga ky subjekt, pretendohet se për vendosjen e materialeve reklamuese-postereve posedojnë Kontratë me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, me nr.Prot.01/2025, datë 11 Janar 2025, e bashkangjitur si provë në përgjigje në ankesë.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Kontratës së LDK-së me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, të datës 11 Janar 2025, ka vërejtur se e njëjta kontratë nuk përmban asnjë të dhënë se operatori ekonomik në fjalë të ketë lidhë ndonjë kontratë me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese, përkatësisht për të pasur të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese t’ia bartë personit të tretë. Gjithashtu, nuk është lëshuar asnjë leje për shfrytëzimin e hapësirave të tjera publike për reklamim. Po ashtu nga komunikimi elektronik në mes të Habib Qorri, udhëheqës i Sektorit Për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, drejtuar Donat Lushaku, është pohuar se ekziston Kontrata publike Kornizë Publike – Furnizime datë 30.10.2019, e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës në njërën anë, dhe Selman Network sh.p.k, e cila është ende në fuqi dhe realizim. Pas konsultimit me menaxherin e kontratës, pritoret janë furnizuar dhe montuar nga shtatori i vitit të kaluar 2024 në kryeqytet, ku në bazë të kontratës pas furnizimit, montimit dhe funksionalizimit të pritoreve, operatori ekonomi Selman Network sh.p.k ka për obligim mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre dhe për tri vite, përfshirë këtu edhe hapësirën reklamuese.

Marrë për bazë përgjigjet e tilla kundërthënëse për raportin kontraktues mes tyre, përkatësisht të drejtat dhe detyrimet nga ky raport, PZAP me datë 23.01.2025 ka kërkuar sqarime nga Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Shpëtim ka dhënë përgjigje në kërkesë, ku ndër tjera ka theksuar se: *“Sektori për shërbime Publike, nuk ka lëshuar dhe nuk posedon ndonjë kontratë për hapësirat reklamuese në pritore e autobusëve. Gjithashtu nuk është lëshuar leje nga ky për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese...”*.

Nga arsyet e paraqitura konstatohet se Selman Network sh.p.k nuk ka pasur kontratë të vlefshme me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e pritoreve dhe hapësirave të tjera, dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi që një të drejtë të tillë t’ia bartë tjetrit, në këtë rast subjektit politik PDK. Mbi këtë bazë është vlerësuar se kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik Selman Network sh.p.k dhe subjektit politik LDK nuk mund të prodhojë efekt juridik në kuptim të krijimit të bazës për shfrytëzim të këtyre hapësirave, përkatësisht vendosjen e posterëve, sepse për vendosjen e posterëve nevojitet të merret leja nga organet kompetente Komunale.

Paneli ka vlerësuar se vendosja e posterave nga subjekti politik LDK respektivisht kandidatet e këtij subjekti në hapësirat publike, në mungesë të lejes përkatëse të lëshuar nga Komuna e Prishtinës i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme

zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në rrugët publike për të cilat nuk posedojnë Pëlqim nga Komuna e Prishtinës, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe të njëjtit subjekt politik për të njëjtën shkelje i është shqiptuar gjobë nga PZAP gjatë këtij procesi zgjedhor.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 201/2025 më datën 29.01.2025

Kryesuesi i Panelit,
Bujar Muzaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



AA.nr.35/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Franciska Zhitija-Ymeri dhe Lumni Sallauka, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.201/2025, të datës 29.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 06.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.201/2025, të datës 29.01.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.201/2025, të datës 29.01.2025, është vendosur: I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.201/2025, dhe Anr.203/2025 të datës 26.01.2025. II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00 (pesëmijëepesëqind) Euro. III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën - II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, lartësia e dënimit me gjobë të shqiptuar është shumë i lartë, ndërsa si pretendim kryesor ankimor i saj është se vendimi i PZAP-së është jo i drejtë dhe i bazuar në fakte, dhe se veprimi i këtij subjekti politik është bërë në përputhje me kontratën e lidhur me subjektin “Selman Network”, dhe kontratës publike kornize të lidhur në mes kësaj të fundit dhe Komunës së Prishtinës, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ndërsa vendimin Anr.201/2025, të datës 29.01.2025, ta anuloj, ashtu që ankesën e subjektit “Lëvizja Vetëvendosje” ta refuzojë.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore



dhe propozoi që ankesa e subjektit politik ankues, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.201/2025, të datës 29.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me datë 26.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.201/2025 dhe Anr.203, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 26.01.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, në rrugën “Xheladin Hana”, në Prishtinë kanë identifikuar banerët/posterët e vendosura në hapësirat/rrugët publike dhe në stacion të trafikut publik, të kandidatëve për deputetë nga radhët e LDK-së, Lumir Abdixhiku, dhe Alban Zogaj, si dhe në rrugën “Shpëtim Robaj” kanë identifikuar banerët/posterët e vendosura në hapësirat/rrugët publike dhe në stacion të trafikut publik, të kandidatëve për deputetë nga radhët e LDK-së, Jehona Lushtaku-Sadriu, Ismet Beqiri, Fadil Aliu dhe Nuredin Ibishi- Leka.

Sipas parashtruesit të ankesave me këtë veprim kandidatët dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve”*. Si provë ankesës i kanë bashkangjitur, fotografi që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës theksohet se: Pretendimi se LDK, ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenin 7 paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, ligjërisht nuk qëndron. Ngase në rastin e ankesës A.nr. 201/2025 dhe A.nr. 203/2025 kemi të bëjmë me vendosje të materialit-posterit në pritore të autobusëve dhe në hapësirat/rrugët publike (the në stacion të trafikut publik. Prova konkrete për rastin në fjalë janë kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik “Selmans Network” me Komunën e Prishtinës-Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, kontratën e lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike mes subjektit politik LDK me operatorin ekonomik “Selmans Network” sh.p. k. si dhe sqarimin e shefit të sektorit për menaxhim të hapësirave publike z. Habib Qorri.

PZAP, i pas shikimit të shkresave të lëndëve dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën*



zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve”.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Kontratës së LDK-së me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, të datës 11 Janar 2025, ka vërejtur se e njëjta kontratë nuk përmban asnjë të dhënë se operatori ekonomik në fjalë të ketë lidhë ndonjë kontratë me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese, përkatësisht për të pasur të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese t’ia bartë personit të tretë. Gjithashtu, nuk është lëshuar asnjë leje për shfrytëzimin e hapësirave të tjera publike për reklamim. Po ashtu nga komunikimi elektronik në mes të Habib Qorri, udhëheqës i Sektorit Për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, drejtuar Donat Lushaku, është pohuar se ekziston Kontrata publike Kornizë Publike - Furnizime datë 30.10.2019, e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës në njërën anë, dhe Selman Network sh.p.k, e cila është ende në fuqi dhe realizim. Pas konsultimit me menaxherin e kontratës, pritoret janë furnizuar dhe montuar nga shtatori i vitit të kaluar 2024 në kryeqytet, ku në bazë të kontratës pas furnizimit, montimit dhe funksionalizimit të pritoreve, operatori ekonomi Selman Network sh.p.k ka për obligim mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre dhe për tri vite, përfshirë këtu edhe hapësirën reklamuese.

Marrë për bazë përgjigjet e tilla kundërthënëse për raportin kontraktues mes tyre, përkatësisht të drejtat dhe detyrimet nga ky raport, PZAP me datë 23.01.2025 ka kërkuar sqarime nga Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Shpëtim ka dhënë përgjigje në kërkesë, ku ndër tjera ka theksuar se: *“Sektori për shërbime Publike, nuk ka lëshuar dhe nuk posedon ndonjë kontratë për hapësirat reklamuese në pritore e autobusëve. Gjithashtu nuk është lëshuar leje nga ky për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese...”*.

Nga arsyet e paraqitura konstatohet se Selman Network sh.p.k nuk ka pasur kontratë të vlefshme me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e pritoreve dhe hapësirave të tjera, dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi që një të drejtë të tillë t’ia bartë tjetrit, në këtë rast subjektit politik LDK. Mbi këtë bazë është vlerësuar se kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik Selman Network sh.p.k dhe subjektit politik LDK nuk mund të prodhojë efekt juridik në kuptim të krijimit të bazës për shfrytëzim të këtyre hapësirave, përkatësisht vendosjen e posterëve, sepse për vendosjen e posterëve nevojitet të merret leja nga organet kompetente Komunale. Paneli ka vlerësuar se vendosja e posterave nga subjekti politik LDK respektivisht kandidatet e këtij subjekti në hapësirat publike, në mungesë të lejes përkatëse të lëshuar nga Komuna e Prishtinës i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për



fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në rrugët publike për të cilat nuk posedojnë Pëlqim nga Komuna e Prishtinës, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe të njëjtit subjekt politik për të njëjtën shkelje i është shqiptuar gjobë nga PZAP gjatë këtij procesi zgjedhor. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se në mënyrë të dretë është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, e paraparë në nenin 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe lartësinë e gjobës së shqiptuar, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme, ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, ashtu si thekson parashtuesi i ankesës, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese, pasi që gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Kontratës së LDK-së me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, të datës 11 Janar 2025, drejtë ka konstatuar faktin se e njëjta kontratë nuk përmban asnjë të dhënë se operatori ekonomik në fjalë të ketë lidhë ndonjë kontratë me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese, përkatësisht për të pasur të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese t'ia bartë personit të tretë. Përveç kësaj, PZAP drejtë ka konstatuar faktin se Sektori për Shërbime Publike nuk posedon ndonjë kontratë për hapësirat reklamuese në pritoret e autobusëve. Gjithashtu, është vërtetuar drejtë edhe fakti se nuk është lëshuar asnjë leje për shfrytëzimin e hapësirave të tjera publike për reklamim. Të gjitha këto rrethana PZAP i ka vërtetuar nga komunikimi elektronik në mes të Habib Qorri, udhëheqës i Sektorit Për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, drejtuar Donat Lushaku, ku është pohuar fakti se ekziston Kontrata publike Kornizë Publike-Furnizime datë 30.10.2019, e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës në njërën anë, dhe Selman Network sh.p.k, në anë tjetër e cila është ende në fuqi dhe realizim.



Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, në vendimin e atakuar se vendosja e postereve nga subjekti politik LDK, respektivisht kandidatët e këtij subjekti në hapësirat publike, në mungesë të lejes përkatëse të lëshuar nga Komuna e Prishtinës konsiderohen si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.08/L228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në lidhje me këtë, drejtë është konstatuar fakti se Selman Network sh.p.k nuk ka pasur kontratë të vlefshme me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e pritoreve dhe hapësirave të tjera, dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi që një të drejtë të tillë t'ia bartë tjetrit, në këtë rast subjektit politik LDK. Mbi këtë bazë drejtë ka vlerësuar Paneli se kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik Selman Network sh.p.k dhe subjektit politik LDK, nuk mund të prodhoj efekt juridik në kuptim të krijimit të bazës për shfrytëzim të këtyre hapësirave, përkatësisht vendosjen e posterëve, sepse për vendosjen e posterëve nevojitet të merret leja nga organet kompetente Komunale.

Gjykatës Supreme i rezulton se shkelja e konstatuar nga PZAP, në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së, lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjoba e shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 5,500.00 €, është i drejtë dhe i ligjshëm, me të cilin vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, përkatësisht jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes. Në anën tjetër, rezulton se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës, ka marr për bazë të gjitha rrethanat e përcaktuara në legjislacionin përkatës, përfshirë këtu shkallën dhe peshën e shkeljes dhe natyrën e shkeljes, si dhe numrin e madh të shkeljeve, bazuar në gjashtë ankesat e paraqitura për shkeljen e natyrës së njëjtë.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtresit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuar se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË

AA.nr.35/2025, datë 06.02.2025



Kryetare e kolegjit
Delushe Halimi
Republika e Kosovës
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS



Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-35/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tënimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ u _____ cas.
dana

Shkak i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebuje precrta)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIGJYKIMI 06.02.25

Numri i shtojcave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lajtëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

06.02.25

(Nënskrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

16.2

Nënskrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Nënskrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Në rast se unrtrejt është anshabot ose nuk është në gjendje të nënskrivjet
dorëzuesit, duke shkruar ligakun pse marrësi nuk e ka vënë nënskrivjet e ve
Atko je primilac nepismen je nje u stanu da se popise, popisuje ga dostavljaoc
napomenom zaslo prihvac nije stavio svoj popis.